


Nr.Prot. 32/24

## KËRKESË



RESPUBLICA

**KËRKUES:** Qendra “Res Publica”,  
person juridik i regjistruar në gjykatë  
me Vendimin nr. 604 dt. 13.04.2010,  
përfaqësuar nga Z. D. M

*Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë*  
*Email: [gendra.respublica@gmail.com](mailto:gendra.respublica@gmail.com)*

**DREJTUAR:** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

*Adresa: “Rruga e Kavajës”, Tiranë*

**Për dijeni:** *Koordinatorës për të drejtën e informimit Znj. Joniada Koçi*

**OBJEKTI:** Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar  
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë  
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut  
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

E nderuar Znj.Koordinatorë,

Qendra Res Publica është e angazhuar ti shërbejë publikut për të bërë transparencën e institucioneve e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në mirëqeverisjen e vendit. Në shërbimin online [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al) ka mbërritur kërkesa e një qytetari për tu informuar në lidhje me:

- A është njoftuar për fillimin e procedimit penal kundër anëtares A V ?
- A është marrë vendim për pezullimin e saj deri në përfudimin e procedimit penal?  
Nëse po, ju lutemi na vini në dispozicion një kopje të vendimit.

Kjo kërkesë bazohet në nenin 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:

*“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.”*

Kopje e dokumenteve të sipërpermdura mund të na i dërgoni në adresën e emailit ose në

*Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë*

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në:

*email: [qendra.respublica@gmail.com](mailto:qendra.respublica@gmail.com)*

**Informacionet e kërkuara mund të na i dërgoni edhe në formatin elektronik në adresën e mësipërme.**

Duke mbetur në pritje të një përgjigjeje të shpejtë dhe pozitive nga ana Juaj, Ju falenderoj për mirëkuptimin.

Me respekt,  
**Av. D M:**  
**Drejtor Ekzekutiv**  
**Qendra "Res Publica"**

Datë më 20.03.2024